



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.01.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4184/15, për z. Kastriot Krasniqi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Prizren, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Kastriot Krasniqi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Prizren, person i autorizuar në një biznes privat dhe njëkohësisht Kryepunëtor për demontim dhe montim të ujëmatësve në Ndërmarrjen Publike K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A - Prizren, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, z. Krasniqi, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuara një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast z. Krasniqi është njoftuar se ushtrimi i funksionit menaxherial në Ndërmarrje private është i ndaluar. Prandaj për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit duhet ti bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve.

Zyrtari i lartë, z. Krasniqi është deklaruar se brenda afatit ligjor do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjenci kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/136/16, në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka bërë shuarje vullnetare të biznesit privat D.P.T "Niti".

Ndërsa, ushtrimi i funksionit si Anëtar i Kuvendit Komunal në Prizren dhe njëkohësisht ushtrimi i funksionit të Kryepunëtorit për demontim dhe montim të ujëmatësve në Ndërnarrjen Publike K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A – Prizren nuk paraqet konflikt interesi. Mirëpo zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të ketë parasyshë deklarimin rast për rast të interesave private lidhur me vendimarrjen e caktuar neni 13 (paragrafi 1,2,3), të Ligjit nr.04/L-051.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

